

BOTA VIRTUALE



Qasja në internet mund të ndihmojë fëmijët të mësojnë më shumë për botën dhe mund të shërbejë si një mjet i dobishëm për zhvillimin e tyre akademik dhe personal.


Por, duke kaluar shumë kohë në internet fëmijët ekspozohen ndaj dhunës që bëhet nga fëmijët e tjerë apo edhe nga të rriturit.


Ngacmimi nëpërmjet internetit shpesh herë mund të ketë pasojë më të rënda se dhuna fizike.


Fëmijët duhet të vetëdijësohen për rreziqet potenciale në internet dhe të përgatiten që t'i tejkalojnë ato rreziqe duke e përdorur internetin me kujdes dhe përgjegjësi.


Cilat janë të drejtat e mia në botën virtuale?





 Kam të drejtë të ndjehem i sigurt dhe të jem i sigurt në internet.


 Kam të drejtë të hulumtoj, të mësoj dhe të kënaqem në internet.


 Kam të drejtë të mbaj të fshehta të dhënat e mia personale (emri, mbiemri, fotografia, ditëlindja, adresa, emri i shkollës, numri i telefonit, etj.)


 Kam të drejtë që të tjerët të mos më shqetësojnë ose ngacmojnë.


 Kam të drejtë t'i injoroj e-mailat dhe mesazhet nga njerëzit të cilët nuk i njoh ose nuk u besoj.

 Kam gjithmonë të drejtë të kërkoj ndihmë nga prindi ose një i rritur.

 Kam të drejtë të mos i përgjigjem ngacmuesve, t'i bllokoj ata, mos t'i lexoj mesazhet e tyre dhe t'u tregoj prindërve që kam qenë viktimë e ngacmimit.


 Kam të drejtë të raportoj tek prindërit, mësuesit, drejtorja e shkollës apo në polici këdo që më ngacmon dhe më fyen.


 Kam të drejtë që gjatë komunikimit në internet mos të përdori emrin tim të vërtetë.


 Kam të drejtë që të mos i ndaj fjalëkalimet e mia me shokë apo shoqe, përveç me prindërit.


Cilat janë përgjegjësitë e mia në botën virtuale?





 Duhet të sigurohem që të dhënat e mia personale të jenë private dhe të mos mund të shihen nga të panjohurit.


 Duhet të sigurohem që të mos flas gjëra shumë të rëndësishme në internet me persona të ndryshëm.


 Duhet të sigurohem që të mos hap asnjë e-mail, faqe interneti apo mesazh të panjohur.


 Duhet të sigurohem që të mos postoj fotografi apo video të të tjerëve pa lejen e tyre.

 Duhet të sigurohem që të mos fyej, ngacmoj apo mashtruj dikë nëpërmjet internetit.

 Duhet të sigurohem që asnjëherë nuk do t'u hakmerrem ngacmuesve.

 Duhet të sigurohem që nuk do të postoj diçka në internet pa u menduar mirë nëse postimi lëndon dikë tjetër.

 Duhet të sigurohem që t'u tregoj prindërve për përvojat e mira dhe të këqija në internet.

 Duhet të sigurohem që kurrë nuk do të shkoj vetë të takohem me dikë që e kam njohur vetëm nëpërmjet internetit.

Email: info@fit-ks.org
www.fit-ks.org
www.internetisigurve.org


Qendra për studime të avancuara
Center for advanced studies



4 European Union
Kosovo

PROMOVIMI DHE MBROJTJA
E TË DREJTAVE TË FËMIJËS

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E MIA NË BOTËN REALE DHE VIRTUALE



Ky projekt i financuar nga BE-ja implementohet nga "Qendra për Studime të Avancuara FIT" dhe menaxhohet nga Qendra për Arsim e Kosovës dhe Forum ZFD


Qendra për studime të avancuara
Center for advanced studies


Qendra për Arsim e Kosovës
Kosovo Education Center


forumZFD



Të drejtat e një fëmije përfundojnë aty ku fillojnë të drejtat e një fëmije tjetër.



Fëmijë të dashur,

Sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës të Kombeve të Bashkuara, gjithkush nën moshën 18 vjeçare konsiderohet fëmijë dhe i ka të gjitha drejtat sipas kësaj Konvente. Edhe Kushtetuta e Kosovës garanton që fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre. Respektimi i të drejtave të njerëzve të tjerë është vital për një botë me plot liri, drejtësi dhe paqe.

Të drejtat e fëmijëve janë të drejta të njeriut. Këto janë të drejta të cilat i kanë të gjithë, pavarësisht moshës, gjinisë, kombësisë dhe karakteristikave tjera. Kështuqë, fëmijët kanë pothuajse të drejtat e njerëzve sikur që i kanë të rriturit. Përveç të drejtave, fëmijët kanë poashtu përgjegjësi, ashtu siç kanë të rriturit në një shoqëri. Të drejtat dhe përgjegjësitë janë të lidhura me njëra tjetrën.

Në këtë broshurë ju do të informoheni që të drejtat dhe përgjegjësitë e juaja janë të njëjta si në botën reale edhe ashtu në atë virtuale.

BOTA REALE



Cilat janë të drejtat e mia në botën reale?

- Kam të drejtë në jetë dhe të zhvillohem shëndetshëm.
- Kam të drejtë që t'i shpreh lirshëm pikëpamjet e mia përderisa nuk i dëmtoj të tjerët.
- Kam të drejtë të kem reputacion të mirë.
- Kam të drejtë që të marrë informacion nga media.
- Kam të drejtë të kem nivel të mjaftueshëm jetese për zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.
- Kam të drejtë që të pushoj dhe të luaj si dhe të marr pjesë në aktivitete argëtuese, kulturore dhe artistike.
- Kam të drejtë të mbrohem nga të gjitha format e shfrytëzimit, abuzimit, dhunës fizike dhe psikologjike, mospërfilljes, keqtrajtimit.



Cilat janë përgjegjësitë e mia në botën reale?



- Duhet të sigurohem që të respektoj të drejtat dhe liritë e të tjerëve dhe nuk do të bëj veprime që paraqesin kërcënim për shoqërinë apo veten time.
- Duhet të sigurohem që t'i dëgjoj të tjerët dhe t'i respektoj ata.
- Duhet të sigurohem që t'i pranoj njerëzit që janë ndryshe nga unë.
- Duhet të sigurohem që të kujdesem për shëndetin tim.
- Duhet të sigurohem që të kujdesem për të tjerët.
- Duhet të sigurohem që të mësoj nga gabimet e mia.
- Duhet të sigurohem që të respektoj mësuesit e mij.
- Duhet të sigurohem që t'a mbajë mjedisin të pastër dhe të shëndetshëm.
- Duhet të sigurohem që të respektoj kulturën dhe besimet e të tjerëve.

